



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:112977

Datë: 17.08.2020

Numri i dokumentit: 01064910

P.nr.117/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Sabrije Rraci me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shere Desku, në çështjen penale kundër të pandehurit: F. (Z.) B. Per shkak të veprës penale „Sulm ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II Nr. 958/2019, të datës. 23.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të dt.07.07.2020 si dhe dhe shqyrtimeve gjyqësore të datave 22.07.2020, 29.07.2020 në prani të Prokurorit të Shtetit, Ersan Qavolli, të pandehurit F. B. mbrojtëses Av. Drita Sopi-Gashi, si dhe i dëmtuari-dëshmitari S. M., si dhe dëshmitarët A. K., A. K.,N. Q. dhe D. B. me datën 29.07.2020, e shpalli aktgjykimin, ndërsa e përpiloi me dt. 06.08.2020 këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

1.F. B. i lindur me dt. ..., R.F.e Gjermanisë, ndërsa tani me banim ne pn. Klinë, i biri i Z.it dhe nënës B., e gjinisë K., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion menaxher i lokA.t „C...”, i gjendjes se mesme ekonomike, i dentifikuar me nr. Personal, nr. personal,....., i nacionA.tetit shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji dhe atë nga data 23.04.2019 deri me dt.23.05.2019.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mirë se:

Me dt. 23.04.2019 rreth orës 14:40 në Stacionin policor në Klinë, sulmon personin zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare dhe atë të dëmtuarin Toger S. M. #..., në atë mënyrë që ditën kritike deri sa i njëjti ka qenë shoqëruar në Stacionin policor në Klinë, për tu intervistuar pasi që paraprakisht kishte penguar personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, pasi që i janë hequr prangat i njëjti sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur në gjoks dhe duke i rrëzuar në dysheme.

Me çka ka kryer vepër penale “ „Sulm ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 2 të KPRK-së, Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,46, dhe 73 si dhe nenit 402.par 2 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së,

GJYKON

Me dënim Burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, duke e llogaritur kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 1 (një) muaji.Gjykata me pëlqimin e të pandehurit dënimin me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i'a shëndërroi **NË DËNIM ME GJOBË shuma në vlerë prej 500**

(pesëqind) Euro, të cilin denim i pandehuri obligohet që ta paguaj në 2 (dy) kiste, pasi aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm.

II.OBLIGOHET: I pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën në vlerë prej 20 € (njëzetë) Euro, si dhe shpenzimet në emër të tarifës për Kompensimit të Viktimave të Krimit 30 (tridhjetë) Euro, gjithsejtë nga **50 (pesëdhjetë) Euro**, në afatin prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

Udhëzohet :I dëmtuari S. M. K. Klinë, që kërkesën pasurore juridike ta reA.zoi në contest civil.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngritur Aktakuzë kundër të pandehurit F. B., nga Klina rr....” pn. për shkak të veprës penale „Sulm ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II Nr.958/2019, të datës. 23.05.2019.

Në shqyrtimin fillestart të mbajtur me dt.05.11.2019, pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, si dhe pasi që të pandehurit i është dhënë mundësia për tu deklaruar për fajsinë apo pafajsinë e tij, duke u njoftuar paraprakisht nga gjykata për favoret dhe pasojat e njërës dhe tjetrës, i pandehuri u deklarua i pafajshëm.

Ndërsa gjykata caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 07.07.2020, 22.07.2020 29.07.2020, ku u dëgjuan i pandehuri dhe i dëmtuari-dëshmitari S. M.,si dhe dëshmitarët A. K. dhe A. K. të propozuar nga prokuroria ndërsa dëshmitarët N. Q.. dhe D. B. jan të propozuar nga i pandehuri.

I pandehuri në fjalën hyrëse deklarohet i pa fajshëm, ndërsa i dëmtuari kërkon ndjekje penale , ndërsa hjek dorë nga kërkesa pasurore juridike.

1.I dëmtuari S. M., a deklaruar se ne jemi njoftuar se ka ndodhur një rrahje tek shtëpia –lokA. B. dhe unë së bashku me disa koleg të mi kemi shku dhe jemi ndal tek lokA. B., personi që ka ardhur në drejtimin tim dhe të A.së, ne e kemi prangos dhe ky djA.-F.i më ka thënë largohu nga këtu dhe qka keni ardhë këtu, kamkërku nga ai që të largohet disa here, mirëpo I njëjti nuk është larguar duke na thënë largonu „Bane---qa po lypni këtu” ne ia kërkuam dokumentin identifikues por I njëjti nuk ka pranuar që të legjitimohet, I njëjti ka pasur sjellje agresive dhe më ka shty me duar dhe gjoks deri te vetura.,Këto veprime na kan shty që ta prangosim, deri sa na ka penguar në kryerjen e detyrës zyrtare.Ne e kemi dërguar në Stacion në dhomën e intervistimit, aty ka qenë rreshteri A. K..Kur ka hy aty i pandehuri ka qenë në këmbë I prangosur, nuk ka pranuar të ulet, pas insistimit tim është ulur, por prap ka reaguuar me fjalë fyese, dhe unë e kam urdhëruar rreshterin A. që t’ia heq prangat.Prokurori me pajtim të gjykatës ia lexon një pjesë të deklaratës së dhënë në prokurori ju keni deklaruar:„derisa e kam urdhëruar të ulet i njëjti më ka sulmuar duke më kapur për fyti dhe duke më goditur në gjoks, në atë moment une kam reaguuar për të neutrA.zuar gjendjen, dhe gjatë kësaj ngjarje F.i është rrëzuar duke e dëmtuar tavolinën e intervistimit”Mbrotësja e të pandehurit Av. Drita Sopi-Gashi se për qka e keni arrestuar F. përgjigja ishte se n aka penguar drejtpërdrejtë duke na shtyrë.

2.Dëshmitari A. K. deklaroi, se po sa jemi njoftuar se ka ndodhur një rrahje ne menjherë kemi dale në vend ngjarje, por ata ikën në drejtime të ndryshme, ku në vendin e ngjarjes ka mbetur F. B.,toger i S. M. i cili e ka pyet se kush ken ata persona që ikën, F.i është kthyer menjë fjalor jo etik, duke thënë se këtu nuk është rraf askush dhe ju banu se këtu është shtëpia ime dhe prona ime.Të njëjtit ju ka kërku që të legjitimohet, por ai ka thënë se nuk dua të ua jap leternjoftimin, duke bër titur se kush jeni ju, unë iu kam ofru duke i thënë se ky është zyrtar policer dhe duhet tja prezantosh dkumentin, prap i njëjti nuk ka pranuar.Gjatë shoqërimit për në stacion vazhdimisht vazhdimisht ka pasur kundërshtime, sin ë vendin e ngjarjës.në pyetje të mbrojtës përgjigjet se po veprimet e ti kanë qenë duke e shtyrë me dorë vazhdimisht S.in.

3. Dëshmitari A. K. deklaron: Se për rastin që është raportuar në rr. „A...” kanë qenë tre persona të arrestuar që e kanë prishë rendin dhe qetësinë. Më kujtohet që F.i ka qenë i prangosur dhe gjatë lëvizjes nuk lejonte që të hyj në stacion policor dhe ka sharë dhe ka bërtit sa ka mujt, unë kam mendur që është duke i sharë të arrestuarit e tjerë e jo zyrtarët policor. Posa është dërgu në dhomën e intervistimeve kam shku menjëherë mbas tij, gjatë intervistimit ka shar dhe bërtit tan kohën. Mua më ka urdhëru togeri S. që t'ia hjek prangat, dhe një kolegj tjetër ia ka hjek, emri nuk më kujtohet por e di që i njëjti u ngrit në këmbë duke bërtitur, edhe pse unë i thojsha ulu ai nuk u uke. Unë e kam parë që pala është ngrit në këmbë dhe ia ka msy togerit dhe e kam vërejtur se ika ra me shqelm në këmbë, pas kësaj janë kacafyt dhe togerit i ka ra kapela në tokë, dhe gjatë kësaj është dëmtuar tavolina e mesit ku unë isha ulur për shkak se ishin të rrëzuar të dyt. Në dhomën e intervistimit kam qenë vetëm unë.

Me propozimin e të pandehurit dëgjohen: N.Q. dhe D.B.

4. Dëshmitari N. Q. deklaron: Se atë ditë unë kam shku te F.i me vëllaun tim, pasi kam pas një problem më herët, aty kam ardhur 10-15 persona dhe F.i fare nuk ka pasur lidhje me atë punë vetëm se kemi qenë në kafe. Policinë e kanë lajmëruar se ata djem kanë armë të ftohta. Policia menihërë e kanë arrestuar F.in, ndërsa ata djem menjëherë kanë ikur nga vendi i ngjarjes. Sa më kujtohet i kanë arrestuar edhe dy djem. F.it policia ia kërkuan letërnjoftimin, polici ia futi dorën në xhep, kur F.i i tha se nuk kam letërnjoftim, policia nuk janë sjellë mirë i njëjti deklaron se F.i nuk i ka sulmuar policinë, ai i ka pasur duart lart. Prokurori pyet se ju ma herët that se policia nuk e kanë kap F., i njëjti përgjigjet se nuk e kam parë. Në pyetje të prokurorit dëshmitari përgjigjet se unë nuk kam qenë mbrenda në stacion kur është kryer vepra.

5. Dëshmitari D. B., i pyetur nga gjykata se a keni lidhje familjare me të pandehurin, i njëjti përgjigjet „po e kam djalin të dajës. Deklaron se ne kemi qenë tek lok. A. i F.it duke ndejtur me te, na nuk e kemi dit se si ka qenë problemi, mandej kanë ardhur nja 20 vetë me vetura dhe i kanë hapur bagazhet dhe janë ofru afër neve, pastaj është lajmëruar policia. Kur kanë ardhë policia direkt kanë ardhur te Franyi ndërsa ata personat tjer kanë ik. Kur e kanë arrestu F. ky ka bërtit pak, sepse dikush tjetër ka qenë i involvuar në atë problem. Në pyetje të mbrojtëses përgjigjet se jo nuk e ka sulmuar gjatë arrestimit F.i të dëmtuarin. I njëjti deklaron se F.i nuk i ka rezistuar policisë. Unë nuk kam qenë brenda në stacion ku është kryer vepra.

A) I pandehuri në mbrojtjen e vet delaron: Se unë kam qenë duke pirë kafe, kanë ardhë 10-15 persona, ka ardhë N. me dy vëllëzërit e tij, unë nuk e kam ditë se ata kanë problem me dikënd. pas pa kata kanë drru biseda të këqija. Unë e kam parë se nëse i la të vazhdojnë situatë përfundon keq. Pas 7-8 min. kanë ardhë Policia dhe është qetësu sizuata, ata biseduan me N.n dhe Rinorin, Rinori ka reaguar duke thënë se këta kanë armë të ftohta, për grupin që ka ikur, unë kam qenë neutral. Unë e kam lajmëtu policinë, të cilët kanë ardhë, dhe unë mendoj se policia kanë koperu me grupin, zyrtari policer S. M. ma ka kërkua letërnjoftimin dhe më ka bërtitur, unë i kam thënë se nuk kam letërnjoftim sepse nuk e mbaj me vete, ai ma ka fut dorën në xhep tu mendu se unë e kam Inj. Unë kam rezistuar të mos më arrestojnë sepse nuk kam dashur që të më arrestojnë, mirëpo kur e kam parë atë situatë jam dorëzuar, dhe i kam ngrit duart lart. Unë ndoshta kam reaguar pak ashpër për këtë ju kërkoi falje, qfardo vendimi që me vjen nga gjykata unë do ta pranoj. I pandehuri deklaron se unë ndoshta kam gabuar, sepse unë për shkak të emocioneve unë i kam shajtur policinë, dhe i kam shajtur „jav.. shtetin” Mënyra si më kanë arrestuar ka qenë e pa drejt. Mua kur më kanë arrestuar, Sëkënderi më ka thënë se ti je „Bir shkinë” unë kam reaguar i kam pas dy duart e lidhura dhe kam reaguar e kam zgjat kryet dhe e kam qit në krahorin e tij, i kam thënë se ti nuk ke të drejt me fol ashtu. „aim ë tha mbylle gojën se kur të shkojmë në stacion ki me pa. Kur kam hy në dhomën e intervistimeve i kam pas duar e lidhura ju kam thënë që të mi heqin prangat, dhe mi kanë heq, dhe jam ulur në karrik dhe ju kam thënë duke qeshur se unë e ti kemi me u pa në gjykatë. Ai më tha mbylle gojën unë i kam thënë se nuk e mbylli gojën, ai më tha nuk mund të më frigosh e aj folke e edhe unë folsha, ai ma ngjiti për gojë unë kam reaguar dhe aim ë ka sulmuar, e jo unë ate. Aty ka fillu përleshja aim ë ka godit dhe unë e kam

goditë, ja kam tërheq dorën. Une kam qenë I ulur pranë tavolinës, kur ka ndodhur përlëshja shpina e jëme e ka thyer tavolinën, aty ka qenë edhe A.i.

Prokurori pyet se në kohën kur kan ardhur policia ju e keni shtyr një polic, i pandehuri përgjigjet se po e kam shtyrë, dhe dokumentin identifikues nuk ja dhash..Prokurori i'a lexon një pjes të deklaratës së dhënë në prokurori, ku keni thënë se poi kam rezistuar poicisë, dhe e keni kapur policing, dhe nuk e keni goditur, por në një moment jemi rrotulluar. I pandehuri përgjigjet se po e kam kapur në momentin kur më ka sulmuar .

Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit deklaron:

Pas administrimit të provave është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë gjendja faktike si në vijim se i akuzuari F. B. me datën 23.04.2019 rreth orës 14:40 në Stacionin policor në Klinë, sulmon personin zyrtar në lidhje me detyrat zyrtare dhe atë të dëmtuarin/policin toger S. M. #5239 në atë mënyrë që, ditën kritike derisa i akuzuari ka qenë i shoqëruar në Stacionin Policor të Klinës për t'u intervistuar, pasi që paraprakisht kishte penguar dhe ofenduar personat zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe në momentin që i janë hequr prangat i njëjti sulmon fizikisht të dëmtuarin S. duke e goditur në gjoks me grushte dhe pastaj me shqelma ku e rrëzon,me këtë ekziston përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer vepër penale **“Sulmi ndaj personi zyrtar”** nga neni 402 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.Provat me të cilat provohet kjo gjendje faktike do të elaborohen si në vijim:

Deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit S.M. i cili gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor deklaroj se ka qenë në plan operativ pra detyrë zyrtare në cilësinë e zyrtarit policor dhe sjellja e të akuzuarit ishte e keqe na ofendojke, derisa e kam urdhëruar të ulet i njëjti më ka sulmuar duke më kapur për fyti dhe më goditur në gjoks në pjesën e majtë anësore...

Deklarata e dëshmitarit A. K. i cili po ashtu është zyrtar policor dhe ishte dëshmitar okular dhe ndër të tjera deklaroj se kanë qenë në detyrë zyrtare, ku sjellja e të akuzuarit F. ka qenë shumë e keqe në stacion ka sharrë, bërtit sa ka mujten...i akuzuari është ngrit në këmbë ka mësyrr prej togerit dhe e kam vërejtë se i ka ra me shkelm në këmbë...Raporti i shpejt dt. 23.04.2019 në të cilin ndër të tjera ceket sjellja e të akuzuarit i cili gjatë gjithë kohës kishte ofenduar zyrtarët policor, u kishte kërkuar mejdan etj.Pasi i janë hequr pranga në stacion ka sulmuar policinë S.M. e goditur dhe ja hedhur kapelen. Raporti i oficerit S.M. KPS ... dt. 23.04.2019 në të cilin ndër të tjera ceket se kishte qenë në detyrë zyrtare dhe F.B. kishte sjellje tejet agresive, duke na sharrë etj... në stacion më ka sulmuar dhe kap për fyti, pastaj më ka goditur me grushte dhe shqelma në drejtimin tim.Shënimi zyrtar i policit A.K. dt. 23.04.2019 në të cilin ndër të tjera ceket se si i akuzuari kishte sjellje të vrazhda, pastaj kishte tentuar ta godas zyrtarin S. M.. Raporti i oficerit A. K. dt. 23.04.2019 në të cilin ndër të tjera ceket se kanë qenë në detyrë zyrtare së bashku me të dëmtuarin zyrtar policor dhe i dyshuari ka qenë shumë agresivë me Policinë është arrestuar dhe dërguar në stacion policor. Raporti i oficerit S. M. dt. 23.04.2019 në të cilin ndër të tjera ceket se i akuzuari kishte sjellje agresive me policë dhe pas arrestim në stacion policor më ka sulmuar duke më gjuajtur me duar, grushte dhe shqelma.Fotot e vendit të ngjarjes ku shihet se pas sulmit nga i akuzuari, të dëmtuarit i kishte rënë kapela dhe dëmtuar tavolina...

I akuzuari – mbrojtja e tij është në kundërshtim me të gjitha provat e përshkruara si më lart e edhe me deklaratat e dhëna më herët nga ana e tij siç janë në polici dhe prokurori, ku ai kishte deklaruar se i kishte rezistuar arrestimit mirëpo gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor tha se nuk i ka rezistuar. Po ashtu ai e pranon se e ka shtyrë policin dhe nuk ja ka dhënë dokumentet. Pra kjo do të thotë se nuk i ka përfillur urdhërat e personit zyrtar. Po ashtu ai e pranon ta ketë kapur policin në vendin e ngjarjes.

Në këtë rast kemi deklaratën e të dëmtuarit e cila në mënyrë identike gjenë mbështetje në deklaratat e dëshmitarëve A. K. dhe A. K. dhe në raportet e zyrtarëve policor dhe së bashku me fotografitë e vendit të ngjarjes e ndërtojnë mozaikun e tërë kësaj ngjarje, karshi një deklaratë të të akuzuarit tejet kundërthënëse lëre që me provat e lartcekura por edhe me mbrojtjen e tij dhënë para organeve të hetuesisë si në polici ashtu edhe në prokurori.

Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve N. Q. dhe D. B. të propozuar nga i akuzuari ato nuk provojnë asgjë lidhur me këtë veprë penale për faktin se këtu vendi i kryerjes është stacioni policor në Klinë e që të njëjtit nuk kanë fare njohuri për veprimet e të akuzuarit aty por ata treguan vetëm për ngjarjen para lokA.t të të akuzuarit e që edhe këtë ngjarje e treguan në mënyrë tejet kundërthënëse sidomos në raport me incizimet e kamerave të sigurisë!

Prandaj Gjykatës i propozoj që kësaj mbrojtje mos t'ia fal besimin sepse është bërë vetëm me qëllim ikjes së përgjegjësisë penale, ngase i akuzuari në disa raste e pranon se ka sharë shtetin, ka rezistuar arrestimit, është konfrontuar me policin, e ka kapur dhe është rrëzuar me të dhe i njëjti është njohës i arteve marciale, prandaj a nuk mjaftojnë të gjitha këto për të përmbushur elementet e kësaj veprë penale! Si veprim të kryerjes ligjvënësi për veprën penale nga neni 402 ka përcaktuar *sulmin* ose *kanosjen serioze* për sulm ndaj personit zyrtar, e që në rastin konkret me veprimet e të akuzuarit duke e shtyrë të dëmtuarin, goditur atë dhe rrëzuar është përmbushur elementi i sulmit. Këto veprime duhet të ndërmerren lidhur me detyrat zyrtare gjersa rrethanë cilësuese është fakti kur këto veprime ndërmerren ndër të tjera edhe ndaj policit, e që prapë referuar faktit se i dëmtuari ishte dhe është zyrtar policor duke kryer detyrat zyrtar konsiderojmë se është përmbushur edhe ky kusht.

Jemi të vetëdijshëm se mbrojtja do të thirret në atë kinse nuk kemi prova të mjaftueshme, të cilat do ta provonin se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale të cekur si më sipër sepse kemi vetëm raportet policore. Por kujtojmë se këto raporte janë shpallur si prova të pranueshme dhe si të tilla janë thujse identike edhe me përshkrimet e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve që i bënë para kësaj gjykate. Po ashtu mbrojtje do të thirret në atë se kinse veprimet e policëve ishin kundërligjore por prapë kujtojmë IPK nuk ka gjetur asnjë provë se i dëmtuari e ka shkelur ligjin. Në fund mbrojtja do të thirret edhe në një inicizim, mirëpo tërheqim vërejtjen se ky inicizim flet vetëm për ngjarjen para lokA.t apo shtëpisë së të akuzuarit, gjersa vendi i kryerjes është stacioni policor në Klinë, prandaj pyetja shtrohet çka provon ky inicizim!? Sidoqoftë edhe pse ky inicizim nuk ka ndonjë relevancë ajo shfaq sjelljen e të akuzuarit në raport me të dëmtuarin qysh nga intervenimi policor i kryer në rr. "A..." në Klinë, po shihet se i dëmtuari me rastin e intervenimit fare nuk kishte të bënte me të akuzuarin por është pikërisht i akuzuari që del nga lokA. i tij dhe shkon në drejtim të të dëmtuarit duke e penguar në kryerjen e detyrave të tij zyrtare me ç'rast i dëmtuari me të drejtë kërkon nga i akuzuari që të legjitimohet për çka ky refuzon dhe këtë refuzim nuk e kundërshton as në mbrojtjen e tij. Po ashtu nga përmbajtja e video inicizimit shihet në mënyrë të qartë sjellja agresive e të akuzuarit në raport me të dëmtuarin dhe policët tjerë.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Drita Sopi- Gashi deklaronë, kundërshtojmë në terësi aktakuzën dhe fjalën përfundimtare nga ana e Prokurorisë dhe kemi shpresuar se edhe Prokuroria duke u bayuar në veprimet shfajësueses të të pandehurit do të tërhiqet nga Aktakuza e cila e ngarkon këtu të akuzuarin F. B. sepse edhe ka obligim ligjor. Mbi këtë bayë nga një aktakuzë e nmgritur pa asnjë bayë ligjore dhe gjatë këtij shqzrtimi gjyqësor është vërtetuar mjaft mire se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar. Fillimisht F.i, është arrestuar pa asnjë baszë ligjore dhe i dorëzuar me duar të ngritura lartë, këtë fakt e argumenton prova materijale-CD e cila ndodhët në shkresat e lëndës dhe Prokuroria nuk e merr parasysh këtë rethanë sepse në fjalën përfundimtare citoj- se Policija gjindet në rendin e parë në luftën kundër kriminalitetit ku-në ate moment policija i kanë kontribuar kryerjen e veprës tjetër penale. Këtë fakt e vërteton prova –CD ku shihen një grup i armatosur në një Xhip të zi në pronën e F. B.. Është e vërtet se F.i ka shkuar në drejtim të policisë dhe i ka njoftuar policinë se këtu në pronën time gjinden një grup prej 15 personave ku shihen edhe në CD të dorëzuar në shkresat e lëndës se është duke u kryer një veprë penale dmth i ka kontribuar luftimit të kriminelitetit ndersa policia nuk e ka marr fare parasysh njoftimin e F.it dhe janë marrur vetëm me F.in ku në rastin konkret ju ka krijuar haqpsira grupit kriminal të ik nga vendi i ngjarjes .Dhe në ate moment policia i kanë kërkuar letërnjoftimin F.it por nuk i kanë krijuar mundësin qe të shkoj nëm veturën

e tij aty ku e kishte afër qe ta merr letërnjoftimin në mënyrë qe të legjitimohet .Dhe menjëherë polici –i dëmtuari i ka futur duart në xhep dhe e ka kapur për teshë dhe me duar të ngritura lartë e ka futur në makinë padrejtësisht,kjo nënkupton se i ka kaluar kompetencat- autorizimet zyrtare. Pala e dëmtuar me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar pretendimin e tij se F.i e ka sulmuar të paktën me një fotografi ku argumenton qe pala e dëmtuar e ka pasur të paktën një lëndim sa më të lehtë. Andaj mbi këtlë bazë duke vërejtur deklaratën jokredibile qe është në kundërshtim me provën materijale si mund të ja falë besim, deklaratës se tij në zyrën e intervistimit ku nuk ekziston asnjë prove .Pra duhet të merr parasysh nenin 262 par. 2 ku gjykata nuk mund të shpallë fajtor një person vetëm me një deklaratë.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaron. Se unë jam i pafajshëm, nëse është ashtu siç thot prokurori se une i kam shkëlmuar unë kisha pas dëshirë qe të sjellin fakte. Unë ate ditë kam penguar qe të kryhet një veprë penale edhe më e rëndë se kjo qe une jam i akuzuar ,ku une ate ditë e kamë bnjoftuar policinë se kjo vetur Xhip e ndalur në rrugë afër shtëpisë sime ku shifet shumë mire ku i nderuari S.M. nuk ka reaguar ashtu siç është dasht. Jam kundër atyrev akuzave qe ata më kanë bërë se une i kam sharë dhe i kam fyer.

Unë e kam thënë edhe në seancën e kaluar e po e them edhe sot se të vetmin gabim qe e kam bërë është qe e kam shajtur shtetin dhe për këtë unë kërkoj falje. I pandehuri lut gjykatën qe të ketë parasysh të gjitha këto qe i kam thënë lidhur me marrjen e vendimit gjyqësor.

Gjykata pas administrimit të provave të prezantuara në aktakuzë, në shqyrtim gjyqësor i vlerësoj secilën me vëmendje një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, në bazë të nenit 361 të KPPRK-së dhe si rezultat i vlerësimit të tyre vërtetoj këtë gjendje faktike si në vijim

Deponimit të mbrojtjes së të pandehurit F. B., gjykata ia falë besimin, pasi i njëjti vetë e pohon se po pendohem qe e kam sharë shtetin, dhe e kam shtyr policing, ndërsa pjesës tjetër të deklaratës i cili potencon se nuk e kam sulmuar të dëmtuarin, nuk ia falë besimin, nga se nga vetë deklarata e tij, I cili vet e pranon se është përlesh me policing, dhe gjatë përleshjes me S.in une e kam rad he është thy tavolina në dhomën e intervistimeve. Ksaj deklarate gjykata nuk ia falë besimin sepse i njëjti ka për qëllim që ti ik përgjegjësisë penale, kjo deklaratë është subjektive.

Poashtu as mbrojtës së të pandehurit Av. Drita-Sopi-Gashi gjykata nuk ia falë besimin, e cila pretendon se me asnjë prove të vetme, I pandehuri nuk e ka kryer VP duke u thirrë në atë se ekziston CD në shkresat e lëndës, si dhe zyrtarët policer nuk janë marrë me grupin qe kan qen afer 1-15 persona, por e kan arrest F.in pa asnjë bazë ligjore, e për më tepër e kan fyer me disa fjaë, qe nuk është aspak etike.

Gjykata deklaratës së tillë nuk mundtia falë besimin, pasi qe fajësia e të pandehurit është vërtetuar nga deklarat e të dëmtuarit dhe dy dëshmitarve ocular qe kan qenë në vendin e ngjarjës.Mirëpo ky pretendim i të autorizuarës së të pandehurit, është dhënë me qëllim të ikjes së përgjegjësisë penale të pandehurit.

Deponimi të dëmtuarit S. M., gjykata i falë besimin, pasi e njëjta ishte në harmoni edhe me deklaratat e dëshmitarve. Deklarata e dëshmitarit A. K. , ishte dëshmitar okular dhe ndër të tjera deklaroj se kanë qenë në detyrë zyrtare, **ku sjellja** e të akuzuarit F. ka qenë *shumë e keqe* në stacion ka sharrë, bërtit sa ka mujten...i akuzuari është ngrit në këmbë ka mësy prej togerit dhe e kam vërejtë se **i ka ra** me shkëlm në këmbë. Poashtu edhe dëshmitari A. K. ka ceket se kanë qenë në detyrë zyrtare së bashku me të dëmtuarin zyrtar policor dhe i dyshuari ka qenë shumë agresivë me Policinë është arrestuar dhe dërguar në stacion policor. Raporti i oficerit S. M. dt. 23.04.2019 në të cilin ndër të tjera ceket se i akuzuari kishte sjellje agresive me policë dhe pas arrestim në stacion policor më ka sulmuar duke më gjuajtur me duar, grushte dhe shqelma.

Kjo deklaratë është në harmoni me provat tjera të nxjerra dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor, si dhe për faktin se gjatë deklarimit të tij gjykata nuk ka vërejtur ndonjë pretendim

tendencioz. Por deklaratat e të dëmtuarit dhe e dëshmitarve ishte objective-reale, dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve N. Q.. dhe D. B. të propozuar nga i akuzuari ato nuk provojnë asgjë lidhur me këtë vepër penale për faktin se këtu vendi i kryerjes është stacioni policor në Klinë e që të njëjtit nuk kanë fare njohuri për veprimet e të akuzuarit aty por ata treguan vetëm për ngjarjen para lokA.t të të akuzuarit e që edhe këtë ngjarje e treguan në mënyrë tejet kundërthënëse sidomos në raport me incizimet e kamerave të sigurisë!

Faktet e vërtetuara nga gjykata

Pas administrimit të provave të propozuara nga prokuroria gjykata i ka konsideruar si të rëndësishme për vendosjen e fakteve relavante në këtë qështje penale, të njëjtat i ka vlerësuar një nga një dhe në lidhmëri me njëra tjetrën në kuptim të nenit 361 të KPPK-së, dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

1). Vlerësimi i provave materiale

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi në bazë të:Shënimi zyrtar i dt. 23.04.2019, raportet e zyrtarve S. M. #... e dt.23.04.2019, A. K.#..., dhe A. K., raporti nga konsulta nr. ... për të pandehurin F. B. e dt. 23.04.2019, fotot e vendit të ngjarjes,procesverbA. mbi caktimin e seancës dëgjimore në kërkesën për caktimin e paraburgimit. ProcesverbA. mbi marrjen e deklaratës së të dëmtuarit S.M në prokurori me dt. 16.05.2019, procesverbA. i marrjes së deklaratëve të dëshmitarve A. K. dhe A. K. në prokurori me dt. 16.05.2019, procesverbA. mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit F B në prokurori me 16.05.2019 si dhe CD me video inqizim.

2. Vlerësimi i provave personale

Gjykata vlerësoi se nga vetë deklarata e të pandehurit, mund të kuptohet fare lehtë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilat ngarkohet, dhe i cili vet e pranon në një farë mënyre, duke i rezistuar zyrtarve policor dhe duke e sharë shtetin, si dhe duke e pranuar se janë përleshur me të dëmtuarin S. M., që është një fakt notor, poashtu gjykata i ka anA.zuar edhe deklaratat e dtë gjitha palëve,si dëshminë e të të dëmtuarit S. M., A. K. dhe A. K. të cilat dëshmi vërtetuan gjendjen faktike se i pandehuri është kryes i veprës penale të lartëcekur. Ndërsa dëshmia e dëshmitarit N. Q.. dhe D. B., ato nuk provojnë asgjë lidhur me këtë vepër penale për faktin se këtu vendi i kryerjes është stacioni policor në Klinë e që të njëjtit nuk kanë fare njohuri për veprimet e të akuzuarit aty por ata treguan vetëm për ngjarjen para lokA.t të të akuzuarit e që edhe këtë ngjarje e treguan në mënyrë tejet kundërthënëse sidomos në raport me incizimet e kamerave të sigurisë!

c) Vlerësimi juridik i çështjes

Me të gjitha provat personale dhe materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të anA.zuara dhe të vlerësuara nga gjykata një nga një si: Dëshmia e të dëmtuarit S. M., si dhe dëshmia e dëshmitarve A.K. A.K. N.Q.. dhe D.B., mbrojtja e të pandehurit, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, e të cilat prova gjykata i ka vlerësuar një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerrë përfundim se në tërësi është vërtetuar, se i pandehuri F. ka kryer veprën penale „sulm ndaj personit zyrtar ‘’ nga neni 402 par. 2 të KPRK-së.Gjykata konsideron se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të lartëcekura si: kundërligjshmëria, dashja si formë e fasjsisë, si dhe vetëdija, andaj përfundon se në veprimet e të të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet inkriminuese të kësaj vepre penale të cilat sajojnë figurat e këtyre veprave penale.

Duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 262 par.1 të KPPRK-së në të cilat përcaktohet: “gjykata nuk e shpallë të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie, apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

Gjatë vlerësimit të provave të prezantuara në shqyrtim gjyqësor që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të të akuzuarit, gjykata nuk ka gjetur asnjë bazë për përjashtimin apo

zvogëlimin e përgjegjësisë së tij, andaj të njëjtin e ka shpallë fajtor dhe penA.sht përgjegjës për veprat e lartëcekura.

Vendimi mbi dënimin

Me qe gjykata e ka gjetur fajtor dhe penA.sht përgjegjës të pandehurin për veprën penale të lartëcekur, para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat e përcaktuara me nenin 73 të KPK-së, e të cilat gjykata i ka vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjatë individuA.zimit të tij gjykata për të pandehurin, ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese, sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, faktin se i njëjti për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin, faktin se i njëjti është i moshës relativisht të re. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar dashjen si formë e fajsisë.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përcaktuara në nenin 73 të KPPRK-së gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar, është adekuat dhe në harmoni me peshën e veprave penale, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore, dhe shkallën e përgjegjësisë penale, në atë mënyrë që me të i njëjti të arrihet qëllimi i dënimit, pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale të ngjashme apo të tjera në të ardhmen, me bindje të plotë se dënimi i shqiptuar do të jetë i drejtë si dhe do të ndikoj si preventivë speciale dhe gjenerale për të pandehurin dhe personat e tjerë për tu përmbajtur në kryerjen e veprave penale të ngjashme apo të tjera.

Vendimi për reA.zimin e kërkesës pasurore juridike u mbështet në dispozitat ligjore të nenit 463 par.2 të KPPRK-së, duke e udhëzuar palën e dëmtuar që të njëjtën ta reA.zoj në kontest të rregullt civil.

Konform dispozitave ligjore të nenit 453 par.1 të KPPRK-së, obligohet i pandehuri, që ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet për kompenzimin e viktimave të Krimin konform ligjit nr. 05/L-036

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, dhe konform dispozitave ligjore te nenit 25 par.2, 26 par.2, 297 par .1, 364, dhe 470 të KPPRK-së, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË

P.nr.117/19, të datës: 06.08.2020

Sekretarja Juridike

Shere Desku

Gj y q t a r j a

Sabrije Rraci

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,

Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.